

EFEKTI I “KURBËS-J” NË
TREGTINË DYPALËSHE:
NDIKIMI I NËNÇMIMIT TË
MONEDHËS NË BILANCIN
TREGTAR NDËRMJET
SHQIPËRISË DHE PARTNERËVE
KRYESORË TREGTARË

Alban Pllaha*

MATERIALI DISKUTIM

12 (71) 2013

BANKA E SHQIPËRISË



** Alban Pllaha, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë
e-mail: apllaha@bankofalbania.org*

Mendimet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë pikëpamjet e Bankës së Shqipërisë.

Dëshiroj ti shpreh mirënjohjen Drejtorit të Departamentit të Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë, Ph.D. Altin Tanku, i cili është iniciatori i idesë së testimit të fenomenit të "kurbës – J" në rastin e Shqipërisë dhe për mbështetjen e vazhdueshme dhënë këtij materiali me ide dhe sugjerime të vjera. Dëshiroj gjithashtu të falenderoj kolegët pjesëmarrës në "Konferencën e 6-të të Kërkimeve Ekonomike në Evropën Juglindore, Tiranë, Nëntor 2012" për komentet e tyre të vlera dhe recensën ndërmjet kolegëve. I jam gjithashtu mirënjohës të gjithë kolegëve të Departamentit të Kërkimeve, veçanërisht z. Gerti Shijaku, znj. Elona Dushku, z. Bledar Hoda dhe z. Ilir Vika për rekomandimet e tyre të vjera dhe për ofrimin e një ambjenti të shkëlqyer kërkimor.

PËRMBAJTJA

<i>Abstrakt</i>	5
1. <i>Hyrje</i>	6
2. <i>Modeli i Bilancit Tregtar</i>	10
3. <i>Rezultatet Empirike</i>	15
4. <i>Përfundime</i>	20
5. <i>Literatura</i>	22
6. <i>Shtojca</i>	24

ABSTRAKT

Ky studim vlerëson ndikimin e kursit të këmbimit në flukset tregtare dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve kryesorë tregtarë, përkatësisht: Eurozona, Italia, Greqia, Gjermania, Kosova dhe Turqia. Materiali synon të evidentojë ekzistencën e fenomenit të “kurbës – J” në tregtinë dypalëshe për periudhën 1998 – 2012. “Modeli i korrektimit të gabimit” duket se është modeli ekonometrik i duhur në identifikimin e ndikimeve afatshkurtra dhe afatgjata të nënçmimit real të kursit të këmbimit vendas (LEK) në bilancin tregtar dypalësh ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë tregtarë. Një nga gjetjet kryesore të këtij materiali është fakti se hipoteza e “kurbës – J” gjen mbështetje vetëm në rastet e tregtisë me Italinë dhe Turqinë. Rezultatet empirike gjithashtu sugjerojnë se një zhvlerësim real i lekut shqiptar ndikon pozitivisht bilancin tregtar në afatin e gjatë, megjithatë, në afatin e shkurtër këto efekte duket se janë statistikisht jo të rëndësishëm.

Fjalë Kyçe: Kurba – J, bilanci tregtar, tregtia dypalëshe, kursi i këmbimit, Shqipëria, zhvlerësimi i monedhës, partnerë tregtarë, kointegrim.

1. HYRJE

Bilanci tregtar është një komponent i rëndësishëm i ekonomisë së një vendi. Teoria ekonomike sugjeron se një bilanc tregtar negativ mund të përmirësohet nëpërmjet zhvlerësimit real të normës së kursit të këmbimit të monedhës vendase, të paktën në afatin e gjatë. Një zhvlerësim real i monedhës vendase pritet të ndikojë njëkohësisht çmimet dhe flukset tregtare. Si rrjedhojë, produktet vendase bëhen më të lira, krahasuar me produktet nga jashtë, sepse me të njëjtën shumë parash të monedhës së huaj mund të blihen më shumë produkte vendase (elasticiteti i çmimeve). Në të njëjtën mënyrë, produktet e huaja bëhen më të shtrenjta për konsumatorët vendas, pasi me të njëjtën shumë parash të monedhës vendase (tashmë e zhvlerësuar) mund të blihen më pak produkte të huaja. Këto lloj zhvillimesh pritet gjithashtu të ndikojnë volumet tregtare në afatin e mesëm dhe të gjatë. Si rezultat i arsytimit të mësipërm, zhvlerësimi i monedhës vendase pritet të rrisë flukset e eksportit të produkteve vendase dhe të tkurrë flukset e importeve, duke përmirësuar rrjedhimisht bilancin tregtar. Megjithatë, përgjigjja e flukseve tregtare (importet dhe eksportet) ndaj nënçmimit të monedhës nuk ndodh në mënyrë të menjëhershme. Teoria e tregtisë ndërkombëtare sugjeron se nënvlerësimi i kursit të këmbimit do të përkeqësonte fillimisht bilancin tregtar në afatin e shkurtër. Arsyetimet themeltare për përkeqësimin fillestar të bilancit tregtar bazohen në këto evidenca: “produkteve në tranzit ju janë vënë çmimet duke ju referuar kursit të vjetër të këmbimit, duke mos reflektuar kështu ndryshimet në kursin e këmbimit”, Krueger (1983). Veç kësaj, Magee (1973) sugjeron se përkeqësimi i bilancit tregtar në afatin e shkurtër shkaktohet pasi nevojitet njëfarë kohe që kontratat tregtare të përshtaten me ndryshimet e kursit të këmbimit. Argumentohet, gjithashtu, se gjatë periudhave të karakterizuara nga luhatshmëri të larta të kursit të këmbimit, tregtarët bëhen më skeptikë për nënshkrimin e kontratave të reja tregtare, duke synuar kështu ti shmangen ekspozimit ndaj rrezikut të shkakuar nga pasiguria e luhatshmërisë të kursit të këmbimit (shihni Bahmani – Oskooee and Kutun, 2008). Në teorinë e tregtisë ndërkombëtare një ndodhi e tillë, përkeqësimi fillestar i bilancit tregtar dhe më pas përmirësimi i tij në afatin e gjatë, si rezultat i zhvlefësimit të kursit të këmbimit njihet si efekti i “kurbës – J”. Emri “efekti i kurbës – J” vjen për shkak të trajektore

në formë “J – je” që ndjek ecuria e bilancit tregtar, i cili ka trend rënës (përkeqësohet) në afatin e shkurtër, për tu përmirësuar më pas në afatin e gjatë, duke ngjasuar me formën e gërmës “J”.

Komponenti i bilancit tregtar bëhet edhe më i rëndësishëm kur nën shqyrtim kemi të bëjmë me një ekonomi të vogël e të hapur si ekonomia shqiptare. Ashtu si edhe pjesa më e madhe e ekonomive të tjera të Evropës Juglindore (EJL), ekonomia shqiptare është e orientuar drejt importeve, e karakterizuar nga një bilanc tregtar negativ përgjatë periudhës 1992 – 2011. Duket se gjatë gjithë kësaj periudhe nevojat e konsumit të brendshëm në vendet e EJL nuk mund të plotësoheshin nga prodhimi vendas (rajonat i EJL), duke i orientuar kështu ekonomitë e rajonit drejt importeve (shih A. Pllaha, 2011). Kjo karakteristikë (bilanci tregtar negativ) është tipike për ekonomitë në tranzicion gjatë kalimit nga një ekonomi e përqëndruar drejt ekonomisë së tregut. Të ardhura nga një ekonomi e përqëndruar, ndërmarrjet vendase në Shqipëri, karakterizoheshin nga një infrastrukturë dhe makineri jo eficiente. Kjo i bënte ato praktikisht të paafta për të konkuruar me ndërmarrje më të përparuara, si për shëmbull, ato të Bashkimit Evropian (BE). Pamjaftueshmëria e prodhimit vendas kombinuar me një kërkesë në rritje nga konsumi vendas çuan drejt një thellimi të vazhduar të defiçitit tregtar përgjatë pjesës më të madhe të periudhës së tranzicionit në Shqipëri.

Shqipëria, ashtu si edhe pjesa tjetër e vendeve të EJL, ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh të tregtisë së lirë dhe nisma të integritit tregtar¹ me qëllim promovimin e rritjes ekonomike dhe të tregtisë në vend. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me BE-në si dhe marrëveshjet dypalëshe të tregtisë së lirë ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e flukseve tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë tregtarë (Shihni A. Pllaha, 2011)².

¹ Në 2009 ratifikohet “Marrëveshja e Stabilizim Asociimit” ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Gjithashtu, përgjatë periudhës 2000 - 2004 Shqipëria dhe pjesa më e madhe e vendeve të EJL kanë nënshkruar ndërmjet tyre marrëveshje dypalëshe për tregtinë e lirë.

² Duke përdorur një qasje me modelin e gravitetit me të dhëna në panel, A. Pllaha (2011) sugjeron se marrëveshjet dypalëshe të tregtisë së lire, ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore, kanë pasur një ndikim pozitiv në intensifikimin e flukseve tregtare dypalëshe.

Fenomeni i kurbës – J po tërheq gjithmonë e më shumë vëmendje në fushën kërkimore të tregtisë ndërkombëtare. Megjithatë, fenomeni i kurbës – J nuk është testuar ende në rastin e ekonomisë shqiptare. Sipas njohurive më të mira të autorit nuk ka ende një studim kërkimor i cili synon të gjejë mbështetje dhe evidenca empirike mbi kurbën – J në Shqipëri. Megjithatë, janë kryer disa studime lidhur me marrëdhënien ndërvepruese ndërmjet kursit të këmbimit dhe flukseve tregtare³.

Duke përdorur të dhëna tremujore për periudhën 1993 – 2003, Agolli (2004), synon të gjejë evidenca empirike mbi ndikimin që ka pasiguria e kursit të këmbimit në volumet tregtare. Gjetja kryesore e këtij studimi sugjeron se, importet drejt Shqipërisë janë më të ndjeshme ndaj luhatshmërive në kursin e këmbimit në afatin e gjatë, ndërsa eksportet janë më të ndjeshme ndaj sjelljeve të kursit të këmbimit në afatin e shkurtër.

Duke përdorur një Model të Korrektimit të Gabimit (MKG), Vika (2006), aplikon të dhëna tremujore (T1 1996 – T4 2005) duke synuar gjetjen e evidencave empirike mbi reagimin e flukseve tregtare ndaj ndryshimeve në të ardhura, çmime relative dhe kurs këmbimi. Ky studim sugjeron se në afatin e gjatë kontribuesi kryesor që ndikon flukset tregtare është niveli real i të ardhurave. Vika (2006) gjithashtu sugjeron se, në afatin e gjatë, importet drejt Shqipërisë ndikohen më së shumti nga çmimet relative, sesa nga kursi i këmbimit. Nga ana tjetër, Vika (2006) gjen se eksportet Shqiptare reagojnë më pak ndaj çmimeve relative. Megjithatë, ai sugjeron se eksportet Shqiptare në afatin e gjatë përcaktohen më së shumti nga luhatjet e kursit të këmbimit lek/euro.

Në studimin e tij, Hoda (2012), vlerëson ndikimet e kursit të këmbimit në tregtinë ndërkombëtare, duke synuar gjetjen e evidencave nëse “kondicioni/kushti Marshall – Lener” qëndron (vërtetohet) në rastin e Shqipërisë. Duke shfrytëzuar qasjen e kointegrimit (duke përdorur të dhëna tremujore 1998 – 2012), Hoda (2012) gjen se flukset tregtare në Shqipëri përgjithësisht

³ Agolli (2004), Vika (2006) dhe Hoda (Konferenca e 6të e Kërkimeve Ekonomike në vendet e EJT; Tiranë, Nëntor 2012), ndërmarrin disa iniciativa gjithëpërfshirëse duke synuar gjetjen e evidencave mbi ndikimin e kursit të këmbimit në flukset tregtare.

ndikohen nga të ardhurat. Për më tepër, rezultatet e Hodës (2012) nënvizojnë faktin se kursi i këmbimit luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e eksporteve shqiptare në afatin e gjatë, duke sugjeruar në këtë mënyrë argumentin që kursi i këmbimit ka një ndikim pozitiv në përmirësimin e bilancit tregtar në Shqipëri.

Situata e tregëtisë në Shqipëri ka ndryshuar ndjeshëm përgjatë viteve të fundit, edhe përsa i përket strukturës së import – eksporteve, ashtu edhe përsa i përket partnerëve tregtarë strategjikë⁴. Disa nga faktorët kryesorë që mund të kenë ndikuar në këto ndryshime janë listuar më poshtë: marrveshjet e tregtisë së lirë me thuajse të gjitha vendet e EJT, marrveshja e tregtisë së lirë me BE-në, kriza në ekonominë globale⁵.

Për këto qëllime është shumë i rëndësishëm, si në aspektin e politikbërjes ashtu edhe në aspektin e kërkimeve akademike, kërkimi mbi evidenca të kurbës – J.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të kërkojë për fakte empirike mbi ekzistencën e fenomenit të kurbës – J për bilancet tregtare të Shqipërisë me partnerët e saj kryesorë tregtarë⁶. Gjatë përpjekjes për ti dhënë përgjigje pyetjes së mësipërme, synohet gjithashtu të merret një pasqyrë më e thelluar mbi ndikimet e kursit të këmbimit në bilancin tregtar të Shqipërisë dhe avantazhet konkurruese të produkteve vendase. Ky material studimor ka strukturën e mëposhtme: Seksioni 2 prezanton modelin dhe qasjen e vlerësimeve; Seksioni 3 diskuton gjetjet empirike dhe rezultatet; ndërsa, Seksioni 4 ofron përmbledhjen dhe përfundimet.

⁴ Ju lutem referojuni shtojcës B, dhe të dhënave të shkruara në seksionin e shtojcës së këtij materiali.

⁵ Partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë (Italia dhe Greqia) u ndikuan në mënyrë të theksuar nga kriza e ekonomisë globale.

⁶ Materiali shqyrton ndikimin e kursit real të këmbimit në bilancet tregtare dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë tregtarë të cilët janë: në terma të përmbledhura (agreguara) Eurozona (EZ) dhe në terma të zbërdhëra (disagreguara) vendet e veçanta si: Kina, Gjermania, Greqia, Italia, Kosova dhe Turqia. Të gjashtë këta partnerë tregtarë së bashku, për Shqipërinë, përbëjnë mbi 65% të tregëtisë me jashtë.

2. MODELI I BILANCIT TREGTAR

Teoria e kurbës – J është prezantuar fillimisht në teorinë e tregtisë ndërkombëtare gjatë fillimit të viteve 70 (fillimi i viteve 1970). Magee (1973) ishte i pari i cili shfaqti interes në një teori të tillë. Qëllimi i studimit të tij ishte analizimi i arsyeve pse bilanci tregtar i SHBA-ve u përkeqësua në afatin e shkurtër, edhe pse dollari amerikan u zhvlerësua në mënyrë të konsiderueshme gjatë vitit 1971, duke krijuar kështu evidencat e para empirike të regjistruara të kurbës – J.

Krueger (1983) nënvizoi ekzistencën e fenomenit të kurbës – J në bilancin tregtar dhe ja atribuoi atë faktit se produktet në proces tranziti janë tashmë të blera, duke mos reaguuar kështu ndaj nënvlerësimeve të kursit të këmbimit. Ishin Bahmani – Oskooee (1985) që më pas ofruan një model të thjeshtëzuar, i cili ndërlidhte bilancin tregtar si dhe variablat e tjerë shpjegues. Kuadri i modelit të tij kishte për qëllim gjetjen e provave mbi ekzistencën e fenomenit të kurbës – J nëpërmjet aplikimit të strukturës të vonesës kohore (lag kohor) për kursin real të këmbimit, duke vlerësuar më pas rëndësinë statistikore të koeficientëve, të vlerësuar në vonesa kohore dhe pritshmëritë për shenjat e tyre. Autorë të ndryshëm, si Karunaratne (1988), Moffett (1989), Brada et al. (1997) etj., kanë përdorur këtë model për të testuar ekzistencën e dukurisë së kurbës – J.

Megjithatë, ky model u përball me disa kritika të konsiderueshme nga autorë të ndryshëm të teorisë së tregtisë ndërkombëtare. Modeli i Bahmani – Oskooee's u kritikua kryesisht për përdorimin e të dhënave jo – stacionare. Sipas Engel dhe Granger (1987) kjo mund të çojë drejt regreseve jo të vërteta (spurious). Në mënyrë që të shmangnin kritikën e mësipërme, kërkuesit e tregtisë ndërkombëtare filluan të aplikojnë testin e kointegrimit për evidentimin e efektit të zhvlerësimit të kursit të këmbimit në bilancin tregtar në afatin e gjatë. Bahmani – Oskooee dhe Kutun (2008) përdorin modelin e korrektimit të gabimit (eng. error – correction model) për të vërtetuar reagimin në afatin e shkurtër. Rose dhe Yellen (1989), Bahmani – Oskooee (1991), Wilson (2001) dhe Bahmani – Oskooee dhe Kutun (2008) janë disa nga autorët të cilët aplikojnë qasjen e sipër përmendur.

Studiuesit ndjekin dy qasje kryesore për studimin e fenomenit të kurbës – J. Grupi i parë i autorëve e studion fenomenin e kurbës – J bazuar në qasjen agregate, duke përdorur qasjen e tregtisë dypalëshe ndërmjet ekonomisë vendase dhe pjesës tjetër të botës. Grupi i dytë i studiuesve ndjek modelin/metodën e zbërthyer (disagreguar), duke vrojtuar bilancet tregtare dypalëshe ndërmjet ekonomisë vendase dhe secilit partner tregtar në veçanti. Grupi i dytë i kërkuesve argumenton se qasja e përmbledhur (e agreguar) mund të neglizhojë fenomenin e kurbës-J ndërmjet partnerëve tregtarë dypalësh. Me fjalë të tjera, për shkak të karakteristikave specifike, bilanci tregtar i ekonomisë vendase mund të përmirësohet me disa partnerë tregtarë, dhe në të njëjtën kohë mund të përkeqësohet me disa të tjerë. Kështu, duke djekur modelin e agreguar, një partner tregtar mund të shërbejë si kundërbalancë e një partneri tjetër, duke rezultuar në informacione të humbura mbi fenomenin e kurbës – J.

Gjetjet nga studimet e autorëve të mësipërm ofrojnë përfundime të ndryshme mbi ndikimin e zhvlerësimit të kursit të këmbimit në bilancin tregtar. Megjithatë, duket se pjesa më e madhe e autorëve bien dakord mbi faktin se bilanci tregtar varet nga variablat kyçe të mëposhtëm: të ardhurat në ekonominë vendase, të ardhurat e jashtme dhe nga kursi i këmbimit. Duke ju referuar teorisë tradicionale, modeli bazë i bilancit tregtar mund të detajohet në mënyrën e mëposhtme: (shihni Rose dhe Yellen, 1989):

$$\log BT_{i,t} = a_0 + a_1 \log Y_{i,t} + a_2 \log Y_{j,t} + a_3 \log KREK + u^t \quad (1)$$

Ku, $BT_{i,t}$ përfaqëson raportin e bilancit tregtar ndërmjet ekonomisë vendase “i” (Shqipërisë në këtë rast) dhe partnerit tregtar “j” (partnerit tregtar të Shqipërisë i cili është marrë në konsideratë). Raporti i bilancit tregtar mund të përcaktohet si raport i importeve shqiptare prej partnerit “j” ndaj eksporteve shqiptare drejt të njëjtit vend, në mënyrë të tillë që tkurrja e BT do të reflektonte një përmirësim të deficitit tregtar⁷. $Y_{i,t}$ qëndron për të ardhurat reale në ekonominë Shqiptare, ndërsa $Y_{j,t}$ qëndron për të ardhurat reale të vendit partner “j”.

⁷ Shihni gjithashtu Bahmani-Oskooee (1991) dhe Ferda (2007).

KREK përfaqëson normën e kursit real të efektit të këmbimit⁸. Në bilancin tregtar, $Y_{i,t}$, $Y_{j,t}$ dhe KREK janë të shprehur në termat e tyre natyrale logaritmike (\ln).

Ashtu siç u shpjegua edhe më sipër, qëllimi kryesor i këtij materiali është të eksplorojë ndikimet e KREK në bilancin tregtar, duke synuar evidenca mbi fenomenin e kurbës – J. Përsa i përket pritshmërive të shenjave nga ekuacioni (1) nuk ka pritshmëri paraprake për a_1 dhe a_2 . Arsyetimi që bëhet është teori tërësisht ekonomike. Si rrjedhojë, teoria ekonomike shpjegon se një rritje e të ardhurave vendase do të na çonte drejt rritjes së importeve prej vendit partner, duke rezultuar kështu në një vlerësim pozitiv të koeficientit a_1 . Megjithatë, nëse rritja e të ardhurave reale vendase vjen si pasojë e rritjes së prodhimit të brendshëm (zëvendësuese të importeve), mund të na çonte drejt një tkurrje të importeve (të cilat tashmë mund të zëvendësohen me produkte vendase). Kjo do të rezultojë kështu në një vlerësim negativ të a_1 . Atëhere, pritshmëritë për shenjën e a_1 mund të jenë si pozitive ashtu edhe negative, në varësi të faktit nëse rritja e të ardhurave të brendshme ndikon më shumë kërkesën apo ofertën. Me të njëjtën logjikë, pritshmëritë për vlerat e a_2 mund të jenë pozitive apo negative. Së fundmi, një zhvlerësim real i monedhës vendase pritet të rrisë flukset e eksporteve dhe të ulë flukset e importeve, duke sugjeruar kështu një pritshmëri pozitive për a_3 ç'ka do të plotësonte kështu edhe "kushtin ML"⁹. Megjithatë, hipoteza e kurbës-J sugjeron se në afatin e shkurtër bilanci tregtar do të përkeqësohet fillimisht, kështu një $a_3 < 0$ do të ishte i pritshëm. Për të testuar kointegrimin afatshkurtër, një pjesë e mirë e autorëve përdorin qasjen Autoregresive të Shpërndarjes në Kohë (ARDL) nga Pesaran et al, (2001). Popullariteti i qasjes Autoregresive të Shpërndarjes në Kohë (qasja ARDL), njohur ndryshe si testimi i caqeve (*bounds testing*), mund t'i atribuohet kryesisht faktit se kjo mënyrë mund të aplikohet, pavarësisht nëse variablat fundamentale janë thjesht I(0), thjesht I(1) ose një kombinim i të dyjave (shih Ferda, 2007).

⁸ Duke ndjekur Egert (2005) po ashtu si edhe autorë të tjerë të fushës norma e kursit real efektiv të këmbimit bazuar në IÇK (indeksi i çmimeve të konsumit) dhe IÇP (indeksi i çmimeve të prodhuesve) përdoren si tregues të normës së kursit të këmbimit.

⁹ Për detaje të tjera referojuni Ferda (2007) fq. 6-7.

Modeli i Korrektimit të Gabimit (ECM) është një model i projektuar për tu aplikuar me seri jo-stacionare që njihen të kenë marrëdhënie ndërvepruese (të integruara). Modeli i Korrektimit të Gabimit zotëron disa mjete të admirueshme në parashikimin e efekteve afatshkurtra ashtu edhe në ato afatgjata. Megjithatë, Modeli i Korrektimit të Gabimit është krijuar për tu aplikuar me seri të dhënash jo-stacionare ose I(1). Ndaj dhe si rrjedhojë, përpara se të merret vendimi për të përdorur ose jo qasjen me Modelin e Korrektimit të Gabimit, seritë duhet të testohen paraprakisht për testin e njësisë së rrënjës (eng. *unit root test*). Për të testuar këtë kusht u kryen testet e *Augmented Dickey-Fuller* dhe *Philips-Perron*.

Rezultatet e testeve sugjerojnë se thujtse të gjitha seritë në nivel duket se janë jo – stacionare, ose I(1) duke kënaqur kështu kushtin e njësisë së rrënjës (*unit root test*). Përjashtimi i vetëm është rasti i bilancit tregtar me Kinën, i cili rezulton si I(0), duke mos lejuar kështu aplikimin e modelit të korrektimit të gabimit në rastin e Kinës. Megjithatë, modeli i korrektimit të gabimit është përshtatshmërisht i aplikueshëm në vlerësimin e ekuacioneve të bilanceve tregtare për pjesën tjetër të vendeve partnere, duke synuar gjetjen e marrëdhënieve ndërvepruese ndërmjet serive (referojuni tabelës 3 në nëndarjen e shtojcës). Modeli i Korrektimit të Gabimit mund të përdoret në mënyrë të përshtatëshme për të parashikuar si efektet afatshkurtra ashtu edhe efektet afatgjata ndërmjet kursit të këmbimit dhe bilancit tregtar.

Duke ndjekur shembullin e Ferda (2007), ne përshtasim qasjen e modelit të korrektimit të gabimit sugjeruar nga Kremers et al. (1992), për të përcaktuar marrëdhëniet kointegruese. Një model i përgjithshëm i korrektimit të gabimit për ekuacionin e bilancit tregtar mund të detajohet si më poshtë:

$$\Delta \log BT_{ij,t} = \alpha_0 + \sum_{k=1}^m \alpha_{1k} \Delta \log BT_{ij,t-k} - \sum_{k=0}^m \alpha_{2k} \Delta \log Y_{i,t-k} + \sum_{k=0}^m \alpha_{3k} \Delta \log Y_{j,t-k} + \sum_{k=0}^m \alpha_{4k} \Delta \log KREK_{t-k} + \lambda EC_{t-1} + u_t$$

ku m qëndron për zgjatjen e kohë vonesave, ndërsa λ qëndron për shpejtësinë e përshtatjes të termit "EC" të korrektimit të gabimit. Rubrika 3 e këtij studimi diskuton testet dhe diagnostikat e zhvilluara mbi modelin dhe seritë kohore, si dhe ofron rezultatet empirike.

3. REZULTATET EMPIRIKE

Për të zbuluar mbi fenomenin e kurbës – J shtatë partnerë tregtarë kyç të Shqipërisë u morën nën shqyrtim. Në mënyrë më specifike: Eurozona, Kina, Gjermania, Greqia, Italia, Kosova dhe Turqia. Për të vlerësuar modelin e balancës tregtare përshkruar në rubrikën e mësipërme aplikohen të dhëna tremujore për periudhën T1 1998 – T2 2012 për partnerët tregtarë të: Eurozonës, Gjermanisë, Greqisë, Italisë dhe Turqisë. Në rastin e Kosovës dhe të Kinës të dhënat e plota që duhen për aplikimin e modelit janë të disponueshme vetëm prej T1 2004 dhe T2 2005, respektivisht¹⁰. Veç kësaj, të dhënat tremujore mbi PBB-në e Kosovës mungojnë. Kështu, duke përdorur programin Eviews-6 u aplikua teknika e interpolimit për të shndërruar PBB – në e Kosovës nga frekuenca vjetore në frekuencë tremujore.

Për të përcaktuar strukturën optimale të vonesave në kohë u përdor kriteri i informacionit “Akaike”. Tabela 1 tregon strukturën e vonesave në kohë sugjeruar nga kriteri “Akaike” për të pestë partnerët e marrë në shqyrtim.

Tabelë 1. Rezultatet e strukturës së vonesave në kohë bazuar në sugjerimet e kriterit AIC (Akaike)

	Vendi Partner:					
	Eurozona	Gjermania	Greqia	Italia	Kosova	Turqia
Nurmi i vonesave në kohë	4 kohë vonesa	1 kohë vonesë	3 kohë vonesa	4 kohë vonesa	3 kohë vonesa	5 kohë vonesa

Diagnostikimi i radhës që nevojitet për të implementuar si duhet modelin e korrektimit të gabimit është testi i “Johansenit” ,për variablat bashkëveprues. Ky test kalohet me sukses për pesë nga gjashtë partnerët tregtarë të Shqipërisë marrë në shqyrtim. Rezultatet e testit të Johansenit sugjerojnë se: në rastet e Eurozonës, Gjermanisë, Greqisë, Italisë dhe Turqisë ekziston një marrëdhënie kointegruese ndërmjet variablave. Ndërsa, në rastin e Kosovës testi

¹⁰ Bilanci tregtar ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës nuk janë të disponueshme për periudhën T1 1998 - T4 2003. Në mënyrë të ngjashme të dhënat e bilancit tregtar ndërmjet Shqipërisë dhe Kinës mungojnë prej T1 1998 - T1 2005.

i Johansenit tregon ekzistencën e 2 marrëdhënieve ndërvepruese (kointegruese) ndërmjet variablave (ju lutem referojuni tabelës 4 në seksionin e shtojcës së këtij materiali).

Tashmë që diagnostikimet e kërkuara janë plotësuar si duhet, mund të përparohet me rezultatet e ofruara nga modeli i korrektimit të gabimit.

Tabela 2 tregon rezultatet e modelit të korrektimit të gabimit për koeficientët afatshkurtër dhe afatgjatë si dhe diagnostikimet statistikore.

Tabelë 2. Vlerësimet afatshkurtra dhe afatgjata bazuar në kohë vonesat sugjeruar nga kriteri AIC (Akaike)

Rezultatet afatshkurtra						
Variablat\Vendet:	Eurozona	Gjermania	Greqia	Italia	Kosova	Turqia
$\Delta \log KREK_{t-1}$	-0.6246 (-0.73)	1.6877 (1.06)	-0.8002 (-0.81)	-2.4490** (-2.90)	5.1744 (0.81)	-5.0676 (-1.17)
$\Delta \log KREK_{t-2}$	0.4430 (0.54)		-0.8419 (-0.85)	-0.9431 (-1.06)	3.1842 (0.51)	-5.2671 (-1.30)
$\Delta \log KREK_{t-3}$	0.1873 (0.21)		0.9223 (0.94)	-0.5819 (-0.70)	-10.838 (-1.72)	-6.5285* (-1.94)
$\Delta \log KREK_{t-4}$	-0.9519 (-1.19)			0.2472 (0.36)		-0.7198 (-0.17)
$\Delta \log KREK_{t-5}$						3.8454** (3.38)
Rezultatet afatgjata						
Konstante	16.75	97.08	36.64	-48.23	-106.75	57.09
$\log Y_{it}$	-0.6806** (6.74)	2.4723** (-5.69)	-1.7742** (5.53)	-1.4002* (1.76)	5.378 (-0.51)	0.7952 (-0.39)
$\log Y_{it}$	3.0767 (-1.57)	-8.5380** (4.01)	2.6497 (-1.39)	0.2043 (0.03)	-11.204 (0.59)	-3.4015 (1.09)
$\log KREK_t$	1.5209** (-3.07)	2.6451** (-2.97)	2.7812** (-2.82)	6.0559** (-3.37)	1.14 (-0.32)	6.4057** (-3.57)
Diagnostikues						
Stat-F	4.087	7.224	2.554	3.282	3.913	3.956
EC_{t-1}	-0.5320 (-2.48)	-0.6926 (-4.66)	-0.2322 (-3.29)	-0.288692 (-3.14)	-0.8529 (-4.78)	-0.7218 (-4.33)
LM	Përbushur	Përbushur	Përbushur	Përbushur	Përbushur	Përbushur
Adj. R ²	0.559	0.408	0.279	0.486	0.583	0.547

KREK = Kursi Real Efektiv i Këmbimit, Y_i = PBB Shqiptare, Y_i = PBB në vendin partner, EC_{t-1} = termi i korrektimit të gabimit, t = tremujori aktual, statistikati-t janë në ().* tregon rëndësinë statistikore në nivelin 10 %, ** tregon rëndësinë statistikore në nivelin 5 %.

Tabela 2 shfaq si efektet afatshkurtra ashtu edhe efektet afatgjata


të prodhuara nga modeli i korrektimit të gabimit. Ashtu siç u përmend edhe më sipër, fokusi kryesor i këtij materiali është të evidentojë evidenca të fenomenit të kurbës – J. Si rrjedhojë, për të mos u zgjatur më shumë seç duhet, seksioni i efekteve afatshkurtra në tabelën më sipër shfaq vetëm rezultatet e normës së kursit real të këmbimit. Siç u theksua edhe më lart, që teoria e kurbës – J të qëndrojë, duhet që në afatin e shkurtër të priten koeficientë negativë (statistikisht të rëndësishëm) të pasuar nga koeficientë pozitivë në afatin e gjatë. Rezultatet afatshkurtra nga tabela e mësipërme tregojnë disa gjetje interesante. Në afatin e shkurtër koeficientët negativë pasohen nga koeficientë pozitivë në të paktën tre nga vendet e marra në konsideratë (në rastet e Greqisë, Italisë dhe Turqisë). Megjithatë, këta koeficientë afatshkurtër janë statistikisht të parëndësishëm në rastin e Greqisë. Rezultatet e mësipërme sugjerojnë se efekti i zhvlefësimit të kursit të këmbimit nuk ka një ndikim statistikisht të rëndësishëm në bilancin tregtar, të paktën në afatin e shkurtër. Vetëm në rastet e Italisë dhe të Turqisë duket që efektet afatshkurta të jenë statistikisht të rëndësishme dhe me shenjë negative sipas pritshmërive. Duke synuar gjetjen e evidencave mbi kurbën – J duhet pasur parasysh edhe shqyrtimi i efekteve afatgjata. Tabela 2 paraqet disa rezultate interesante në lidhje me efektet afatgjata të kursit të këmbimit në bilancin tregtar. Për katër nga gjashtë partnerët tregtarë të marrë në shqyrtim zhvlerësimi real i kursit të këmbimit duket të ketë një efekt afatgjatë. Koeficientët e kursit të këmbimit të të gjashtë partnerëve tregtarë kanë shenjë pozitive në afatin e gjatë. Megjithatë, koeficientët afatgjatë të efektit të kursit të këmbimit mbi bilancin tregtar në rastin e Kosovës duket se janë statistikisht të parëndësishëm. Nga ana tjetër, zhvlerësimi i kursit të këmbimit në Shqipëri duket se ndikon pozitivisht bilancin e saj tregtar me Eurozonën, Gjermaninë, Greqinë, Italinë dhe Turqinë në afatin e gjatë. Teknika e testit të Johansenit u përdor për të identifikuar ekzistencën e marrëdhënieve ndërvepruese (kointegruese) ndërmjet variablave në modelin e korrektimit të gabimit.

Gjithashtu, kushti i LM (*LM condition*) plotësohet për të gjashtë partnerët tregtarë, duke mos shfaqur shenja të evidencave të ndërvartësisë në seri (eng. *serial correlations*). Teoria mbi modelet e korrektimit të gabimit sugjeron se një rezultat, statistikisht i rëndësishëm, i koeficientit EC_{t-1} (koeficienti i korrektimit të gabimit) më i vogël se “1” me shenjë negative mbështet ekzistencën e


marrëdhënies ndërvepruese (kointegruese). Rezultatet e treguara në seksionin e diagnostikave të tabelës 2 konfirmojnë se ky kusht plotësohet për të gjashtë partnerët tregtarë.

Plotësimi i kushtit të kointegrimit mundëson hapat e tjerë diagnostikues drejt qëllimit, që është evidentimi i fenomenit të kurbës-J. Siç përmendet edhe më herët në material, fenomeni i kurbës-J duhet të karakterizohet nga koeficientë negativë në periudhat e kohëvonesave afatshkurtra të pasuara nga koeficientët pozitivë në afatin e gjatë. Mbas realizimit të diagnostikimeve dhe analizave të përmendura më sipër, duket qartë se fenomeni i kurbës J qëndron vetëm në rastet e Italisë dhe Turqisë. Në afatin e shkurtër zhvlerësimi real i lekut shqiptar duket të ndikojë negativisht bilancet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, si dhe ndërmjet Shqipërisë e Turqisë të pasuara më pas nga një përmirësim i këtyre dy bilanceve tregtare në afatin e gjatë.

Teknika e reagimit ndaj impulseve duke shfrytëzuar programin “Eviews 6” u përdor për të shqyrtuar reagimin e bilancit tregtar ndaj kursit të këmbimit. Po kështu, kjo teknikë mundëson vëzhgimin në kohë të reagimit të bilancit tregtar ndaj një shoku të pësuar nga kursi i këmbimit.



Grafik 2: Accumulated Response of LOG(TB_IT_SA) to Cholesky One S. D. LOG(REER)*-1 Innovation



Grafikët 1 dhe 2 më lart, pasqyrojnë reagimet e bilanceve tregtare dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë (Grafiku 1) dhe ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë (Grafiku 2) si reagim ndaj zhverësimit real të lekut shqiptar të cilat janë në formën e kurbës – J.

Teknika e reagimit ndaj impulseve gjithashtu mundëson vizualizimin në mënyrë grafike të reagimit të bilancit tregtar ndaj zhvlerësimit real të lekut shqiptar. Siç tregon dhe vazhdimësia e vijave të lakuara në dy grafikët e mësipërm, bilancet tregtare përkeqësohen në afatin e shkurtër, dhe mbas disa tremujorëve (5 tremujorë në rastin e Turqisë dhe 4 tremujorë në rastin e Italisë) bilancet tregtare fillojnë të përmirësohen, duke arritur nivele të reja të përmirësuara të bilanceve tregtare. Në të dy grafikët e mësipërm linjat e lakuara tregojnë një trajektore të qartë të formës së gërmës “J” të reagimit të bilanceve tregtare ndaj goditjeve në lekun shqiptar.

4. PËRFUNDIME

Teoria e tregtisë ndërkombëtare sugjeron se bilanci tregtar dhe rritja ekonomike mund të përmirësohen nëpërmjet zhvlerësimit real të monedhës vendase. Një zhvlerësim real i monedhës vendase pritet të rrisë prodhimin vendas (eksportet) dhe të reduktojë importet, duke çuar kështu drejt një bilanci tregtar të përmirësuar. Në 1973, Magee (1973) prezantoi teorinë e kurbës-J. Kjo teori sugjeron se bilanci tregtar nuk reagon menjëherë pozitivisht ndaj zhvlerësimit të kursit të këmbimit. Teoria e kurbës-J sugjeron se reagimi i bilanci tregtar ndaj nënçmimit të kursit të këmbimit është i tillë që përkeqësohet fillimisht në afatin e shkurtër, për tu përmirësuar më pas në afatin e gjatë. Që prej asaj kohe teoria e kurbës-J po tërheq gjithnjë e më shumë vëmendjen e akademikëve të teorisë së tregtisë ndërkombëtare. Edhe pse ka pasur disa nisma mbi evidentimin e fenomenit të kurbës-J, disa shtete në zhvillim duke ju referuar njohurive më të mira të autorit, nuk ka pasur asnjë nismë mbi testimin e fenomenit të kurbës-J në Shqipëri.

Qëllimi kryesor i këtij materiali ishte të testojë hipotezën e kurbës-J ndërmjet Shqipërisë dhe gjashtë prej partnerëve të saj kryesorë tregtarë (Eurozona, Gjermania, Greqia, Italia, Kosova dhe Turqia). Duke përdorur qasjen e modelit të korrektimit të gabimit, të dhënat nga T1 1998 – T2 2012 (T1 2004 – T2 2012 në rastin e Kosovës) u aplikuan për të testuar fenomenin e kurbës J. Pas realizimit të testeve statistikore dhe diagnostikimeve që nevojiteshin, rezultatet e përftuara ofrojnë disa përfundime interesante. Hipoteza e kurbës-J mbështetet vetëm në rastet e tregtisë me Italinë dhe Turqinë. Përfundimet sugjerojnë se zhvlerësimi real i lekut shqiptar nuk ka një ndikim domethënës në bilancet tregtare, të paktën në afatin e shkurtër (përveç rasti të Italisë dhe Turqisë, koeficientët e të katërt partnerëve të tjerë tregtarë janë të pa rëndësishëm statistikisht në afatin e shkurtër). Në rastin e Greqisë koeficientët afatshkurtër shfaqen me shenjën e pritur negative e pasuar nga shenja pozitive në afatin e gjatë, duke mbështetur kështu hipotezën e kurbës-J. Megjithatë, në afatin e shkurtër, koeficientët në fjalë janë statistikisht të parëndësishëm. Nga ana tjetër, zhvlerësimi real i lekut Shqiptar duket të ndikojë pozitivisht bilancet tregtare në afatin e gjatë. Rezultatet e modelit të korrektimit të gabimit sugjerojnë

se për pesë nga gjashtë partnerët tregtarë (koeficientët afatgjatë për Kosovën janë statistikisht të parëndësishëm)¹¹, zhvlerësimi real i lekut shqiptar, në afatin e gjatë, ka një ndikim pozitiv statistikisht të rëndësishëm në bilancin tregtar.

Rezultatet empirike të këtij studimi sugjerojnë se zhvlerësimi real i monedhës vendase në Shqipëri ka një ndikim në bilancin tregtar dypalësh, të paktën në aspektin afatgjatë. Megjithatë, rezultatet gjithashtu sugjerojnë se ndikimet e nënçmitmit real të lekut shqiptar në bilancin tregtar nuk janë të menjëhershme. Përfundimet e rezultateve sugjerojnë se kursi i këmbimit mund të përdoret nga politikëbërësit si një instrument efikas për të promovuar eksportet, megjithatë, efikasiteti i këtij mjeti nuk është i menjëhershëm. Gjetjet empirike gjithashtu tregojnë se zhvlerësimi real i lekut shqiptar mund të ketë ndikuar në përmirësimet e fundit të bilancit tregtar të Shqipërisë (prej 2008 bilanci tregtar i Shqipërisë ka treguar shenja përmirësimi), megjithatë, studime me të thelluara nevojiten mbi vertetimin empirik të këtyre çështjeve.

Autori propozon nevojën për thellimin e mëtejshëm të studimit të bilancit tregtar për sektorin e shërbimeve. Veç kësaj, fenomeni i kurbës J ka nevojë të testohet si në nivelin sektorial ashtu edhe në kompozimin ndërmjet produkteve dhe shërbimeve, duke synuar evidenca më të detajuara mbi avantazhet e mundshme konkurruese si rezultat i zhvlerësimit të kursit.

¹¹ Siç theksohet edhe më herët ekuacioni i bilancit tregtar me Kosovën përdor seri kohore shumë të shkurtra (T1 2004 – T2 2012), kështu rezultatet e përfuara nga aplikimi i modelit të korrektimit të gabimit mund të kenë disa mangësi si rrjedhojë e serive kohore të shkurtra.

5. LITERATURA

Agolli, M. (2004), "Efektet e Luhatshmërisë të Kursit të Këmbimit në variacionet e Tregtisë," Qendra shiptare për tregtinë ndërkombëtare, materiale kërkimore, maj 2004.

Bahmani-Oskooee and Kutun. (2008) "The J-Curve in the Emerging Economies of Eastern Europe" The Center for Research on International Economics and Department of Economics The University of Wisconsin-Milwaukee Milwaukee, WI 53201.

Bahmani-Oskooee, M. (1985), "Devaluation and the J-Curve: Some Evidence from LDCs", *The Review of Economics and Statistics* 67(3), 500-504.

Bahmani-Oskooee, M. (1991), "Is there a Long Run Relation Between the Trade Balance and the Real Effective Exchange Rate of LDCs?", *Economics Letters*, 36(4), pp. 403-407.

Brada, J. C., A. Kutun and S. Zhou, (1997). "Exchange Rate Policy and Outward Orientation Developing Countries: The Turkish Experience", *Journal of Development Studies*, Vol. 33, pp. 675-692.

Engle, R. F., and C. W. J. Granger (1987). "Cointegration and Error Correction: Representation, Estimation, and Testing," *Econometrica*, 55 (2), 251-76.

Ferda, H. (2007), "The Bilateral J-curve: Turkey versus her 13 Trading Partners" MPRA Paper No. 3564, posted 07. November 2007

Hoda, B. (2012), "Roli i kurseve të këmbimit në Modelet ndërkombëtare të tregtisë: A qëndron për Shqipërinë Kushti Marshall-Lerner?", *Banka e Shqipërisë, Workshop-i i 6të i Kërkimeve në Evropën juglindore, Tiranë, nëntor 2012.*

Karunaratne, Neil Das (1988), "Macro-Economic Determinants of Australia's Current account 1977-86

Account, 1977-86," *Weltwirtschaftliches Archiv*, Band 124, Heft 4, pp. 712-28.

Kremers, J. J. M., Ericson, N. R. and Dolado, J. J. (1992) *The power*

of cointegration tests, *Oxford Bulletin of Economics and Statistics*, 54, 325-348.

Krueger, A. D. (1983) "Exchange rate determination", Cambridge University Press, Cambridge.

Magee, Stephen P. (1973), "Currency Contracts, Pass Through and Devaluation", *Brooking Papers on Economic Activity*.

Moffett, Michael H. (1989). "The J-Curve Revisited: An Empirical Examination for the United States", *Journal of International Money and Finance*, Vol. 8, pp. 425-444.

Pesaran, M. H., Y. Shin, and R. J. Smith. 2001. "Bound Testing Approaches to the Analysis of Level Relationship," *Journal of Applied Econometrics*, 16, 289-326.

Pllaha, A. (2011), "Marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe integrimi tregtar midis vendeve të Evropës Juglindore: Vlerësime të Modelit të Gravitetit," *Workshop-i i 5të i Kërkimeve në Evropën juglindore; Tiranë, nëntor 2011*.

Vika I. (2006) "Kursi real efektiv i këmbimit në Shqipëri: konceptet dhe matja e tij", *Banka e Shqipërisë, Material nr.2 (18)*.

Rose, A.K., and J.L., Yellen (1989), "Is There a J-Curve?" *Journal of Monetary Economics* 24(1), 53-68.

Wilson, Peter. (2001), "Exchange Rates and the Trade Balance for Dynamic Asian Economies Does the J-Curve Exist for Singapore, Malaysia and Korea?", *Open Economies Review*, Vol. 12, pp. 389-413.

6. SHTOJCA

SHTOJCA A

Tabelë 3. Rezultatet e testit për njësinë e rrënjës

	Testi ADF			Testi PP		
	c	t & c	Asnjë	c	t & c	Asnjë
		Niveli			Niveli	
pbb_al	[.9995]	[.5961]	[.8922]	[.9901]	[.7170]	[1.000]
pbb_ch	[1.000]	[.9959]	[.9995]	[1.000]	[.9992]	[1.000]
pbb_ez	[.3346]	[.3696]	[.9465]	[.3504]	[.7898]	[.9926]
pbb_ger	[.8036]	[.2067]	[.9967]	[.8504]	[.3808]	[.9930]
pbb_gr	[.2091]	[1.000]	[.3994]	[.2949]	[1.000]	[.8556]
pbb_it	[.1349]	[.4882]	[.8445]	[.1953]	[.8040]	[.9015]
pbb_ks	[.6914]	[.1067]	[.9999]	[.6893]	[.0959]	[.9999]
pbb_tr	[.9884]	[.3322]	[.9990]	[.9884]	[.4031]	[.9990]
reer	[.0042]	[.3404]	[.0817]	[.0125]	[.3657]	[.1873]
tb_ch	[.0024]	[.0010]	[.0005]	[.0024]	[.0010]	[.0005]
tb_ez	[.3354]	[.0517]	[.3677]	[.0358]	[.0340]	[.2453]
tb_ger	[.0320]	[.0334]	[.6135]	[.0650]	[.0364]	[.3762]
tb_gr	[.0556]	[.0858]	[.4902]	[.1035]	[.2270]	[.4694]
tb_it	[.0160]	[.0329]	[.0775]	[.0105]	[.0035]	[.0778]
tb_ks	[.1732]	[.5867]	[.6085]	[.0036]	[.0256]	[.4208]
tb_tr	[.0247]	[.0167]	[.0458]	[.0174]	[.0132]	[.0531]
		Ndryshimi i parë			Ndryshimi i parë	
	c	t & c	Asnjë	c	t & c	Asnjë
pbb_al	[.0114]	[.0125]	[.7744]	[.0000]	[.0000]	[.0032]
pbb_ch	[.5688]	[.0427]	[.6922]	[.0000]	[.0000]	[.0053]
pbb_ez	[.0249]	[.0647]	[.0050]	[.0187]	[.0647]	[.0040]
pbb_ger	[.0000]	[.0002]	[.0000]	[.0000]	[.0001]	[.0000]
pbb_gr	[.8818]	[.0001]	[.3870]	[.0027]	[.0001]	[.0002]
pbb_it	[.0074]	[.0207]	[.0005]	[.0063]	[.0173]	[.0004]
pbb_ks	[.0000]	[.0000]	[.0017]	[.0000]	[.0000]	[.0000]
pbb_tr	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]
reer	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]
tb_ch	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0001]	[.0000]	[.0000]
tb_ez	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]
tb_ger	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]
tb_gr	[.0012]	[.0061]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]
tb_it	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]
tb_ks	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]
tb_tr	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]	[.0000]

Tabela 3. shkurtime: pbb = Prodhimi i Brendshëm Bruto, reer = Kursi Real Efektiv i Këmbimit, tb = Bilanci Tregtar, al = Shqipëria, ch = Kina, ez = Eurozona, ger = Gjermania, gr = Greqia, it = Italia, ks = Kosova dhe tr = Turqia


Tabala 4. Testi i kointegrimit Johansen (eng. *Johansen cointegration test*)

Vendi:						
	Eurozona	Gjermania	Greqia	Italia	Kosova	Turqia
Lidhjet bashkëvepruese ndërmjet variablave	1	1	1	1	2	1

SHTOJCA B

SHTOJCA B. 1

Struktura e partnerëve tregtarë të Shqipërisë ka pësuar zhvillime të rëndësishme gjatë periudhës 2003 – 2012. Megjithatë, zhvendosjet më të njohura janë në partnerët tregtarë të Shqipërisë, Italia dhe Greqia, peshat e eksporteve të të cilave ndaj totalit të eksporteve kanë pasur një tendencë rënëse midis viteve 2008 dhe 2012. Kështu që, eksportet me Italinë në vitin 2008, të ponderuara ndaj totalit të eksporteve, përbënin pothuajse 61.76%. Megjithatë, në vitin 2012, pesha e eksporteve ndaj Italisë përbënte vetëm 52.75% ndaj totalit të eksporteve, duke shfaqur një tendencë rënëse nga viti në vit. Një panoramë e ngjashme shfaqet dhe me Greqinë, partnerin e dytë më të rëndësishëm tregtar tradicional të Shqipërisë. Peshat e eksporteve me Greqinë, ndaj totalit të eksporteve, janë tkurrur me pothuajse 5 pikë përqind (2008 – 2012), duke treguar një tendencë të qartë rënëse nga viti në vit.



Nga ana tjetër, eksportet me Spanjën dhe Turqinë janë rritur në mënyrë të konsiderueshme. Kështu, pesha e eksporteve me Spanjën, ndaj totalit të eksporteve u rrit nga pothuajse 0.15 në vitin 2008 në rreth 8.44% në vitin 2012, duke treguar një tendencë të qartë rritëse nga viti në vit. Peshat e eksporteve me Turqinë gjithashtu

janë rritur në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2008 deri në vitin 2012, duke u rritur me pothuajse 4.55 pikë përqind. Eksportet e Shqipërisë me pjesën tjetër të botës gjithashtu janë rritur në mënyrë të konsiderueshme (me pothuajse 3 pikë përqind) midis viteve 2008 dhe 2012. Kosova gjithashtu është bërë një partner tregtar i rëndësishëm i Shqipërisë në vitin 2012, duke përbërë rreth 7% të eksporteve të Shqipërisë në vitin 2012. Gjermania dhe Kina mbeten partnerë tregtarë të qëndrueshëm ndaj eksporteve të Shqipërisë.

Të përballur me krizën financiare (gjatë gjithë periudhës 2008 – 2012), e cila preku kryesisht partnerët kryesorë tradicionalë tregtarë të Shqipërisë (Italinë dhe Greqinë), eksportuesit shqiptarë duket të jenë zhvendosur drejt tregjeve të rinj eksportues, të tillë si Turqia, Spanja dhe pjesa tjetër e botës.

SHTOJCA B. 2

Tabelë 5. Përbërja e eksporteve shqiptare në mallra, 2008 – 2012, në % (SITC, përshkrim)

Përbërja e eksporteve në mallra 2008 - 2012						
Pesha në %						
KODI dhe PËRSHKRIMI (SITC)	2008	2009	2010	2011	2012 (T1+T2)	Ndryshimet e rritjes së peshave në pikë përqind 2012 - 2008
0. Ushqime dhe kafshë të gjalla	3,5	4,8	3,6	3,4	3,9	0,4
1. Pije dhe duhan	0,3	0,5	0,4	0,3	0,4	0,1
2. Materiale të papërpunuara	11,8	10,8	11,6	10,5	9,8	-2,0
3. Lëndë djegëse	8,9	12,1	18,0	21,2	24,9	16,0
4. Yndyrna bimore dhe shtazore	0,0	0,0	0,1	0,1	0,1	0,1
5. Produkte kimike	1,1	1,7	1,0	1,3	0,9	-0,2
6. Mallra të përpunuar	25,3	18,1	24,6	25,2	23,2	-2,1
7. Makineri dhe pajisje	4,1	4,6	4,2	4,0	3,8	-0,3
8. Mallra të tjerë të përpunuar	44,9	47,4	36,6	33,9	33,0	-11,9
9. Mallra të paklasifikuara diku tjetër	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
TOTALI	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0

Burimi: Llogaritje të vetë autorit duke përdorur të dhënat e Bankës së Shqipërisë.

Pesha e zërit “Lëndë djegëse” ndaj eksporteve totale në mallra është rritur dukshëm, nga 8.9% në vitin 2008 në 24.9% në vitin 2012, duke shfaqur një tendencë të lartë rritëse nga viti në vit. Megjithatë, pesha e zërit “Mallra të tjerë të përpunuar” ndaj totalit të eksporteve të mallrave u tkurr me pothuajse 12 pikë përqind (nga 44.9% në vitin 2008 në 33.0% në vitin 2012), kryesisht ndikuar nga eksportet e reduktuara të kategorive “Tekstile dhe artikuj të tjerë tekstile” (-10.1 pikë përqind) dhe “Këpucë, veshje të kokës dhe çadra” (-2.0 pikë përqind).

SHTOJCA B. 3

Tabelë 6. Përbërja e importeve shqiptare në mallra gjatë viteve 2008 – 2012, in % (sipas SITC, përshkrimi)

Përbërja e importeve në mallra 2008 - 2012						
Pesha në %						
KODI dhe PËRSHKRIMI (SITC)	2008	2009	2010	2011	2012 (T1 + T2)	Ndryshimet e rritjes së peshave në pikë përqind 2012 - 2008
0. Ushqime dhe kafshë të gjalla	11,9	12,2	12,7	12,1	12,8	0,9
1. Pije dhe duhan	3,2	3,8	4,1	3,3	3,5	0,4
2. Materiale të papërpunuara	2,1	2,9	1,8	1,4	1,4	-0,7
3. Lëndë djegëse	16,1	11,8	13,8	17,5	19,8	3,7
4. Yndyma bimore dhe shtazore	1,4	1,2	1,2	1,3	1,3	-0,2
5. Produkte kimike	9,7	11,2	11,1	10,6	11,7	1,9
6. Mallra të përpunuar	23,8	25,0	26,3	24,8	21,5	-2,2
7. Makineri dhe pajisje	22,0	22,8	19,4	20,1	18,9	-3,0
8. Mallra të tjerë të përpunuar	9,9	9,1	9,5	9,0	9,0	-0,9
9. Mallra të paklasifikuara diku tjetër	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
TOTAL	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0

Burimi: Llogaritje të vetë autorit duke përdorur të dhënat e Bankës së Shqipërisë.

Struktura e importve në mallra është ndikuar kryesisht nga kategoritë e zërave “Lëndë djegëse” dhe “Makineri dhe pajisje”. Importi i “Lëndëve djegëse” është rritur me rreth 3.7 pikë përqind gjatë kësaj periudhe (nga 16.1% ndaj totalit të importve në mallra në vitin 2008 në 19.8% në vitin 2012). Kontribuesit kryesorë të kësaj rritjeje në importe janë kategoria e “Produkte minerale”e cila për të njëjtën periudhë u rrit me 2.9 pikë përqind. Pesha e importve të zërave “Mallra të përpunuar” dhe “Makineri dhe pajisje” ndaj totalit të eksporteve të mallrave (2008-2012) ka shfaqur tendencë rënëse, duke rënë përkatësisht nga 2.2 në 3.0 pikë përqind. Kontribuesit kryesorë në këtë rënie të tillë janë kategoritë e zërit “Metali bazë dhe artikuj prej metali bazë” dhe “Makineri e pajisje mekanike, pajisje elektrike” importet e të cilëve janë tkurrur përkatësisht me 2.5 dhe and 3.9 pikë përqind.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Alban Pllaha

Efekti i "kurbës-J" në tregtinë dypalëshe:

Ndikimi i nënçmimit të monedhës në
bilancin tregtar ndërmjet Shqipërisë dhe
partnerëve kryesorë tregtarë- /

Pllaha Alban - Tiranë:

Banka e Shqipërisë, 2013

-32 f; 15.3 x 23 cm.

Bibliogr.

ISBN: 978-99956-42-89-6.

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

*Në qoftë se dëshironi të keni kopje të
shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:*

Banka e Shqipërisë

Sheshi "Avni Rustemi", Nr. 24, Tiranë, Shqipëri

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11

Faks: + 355 4 2419408

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 420 kopje